

Begzad BALIU

**PROFESOR KOLEC TOPALLI ISHTE AQ TOKËSOR ME JETËN DHE
PO AQ QIELLOR ME VEPRËN**

UDC 811.18(091)

Dy vjet më parë më parë, tek po bisedonim në Prishtinë për lodhjen që ia kishte shkaktuar veprimtaria e tij shkencore, në mënyrë të veçantë “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, të cilit sapo ia kishte dhënë dorën e fundit, veç tjerash më thoshte se nuk e dinte se si dhemb koka, e megjithatë ndjente nevojën që të pushonte një kohë, a ndonjë vit, dhe vetëm atëherë t’iu rikthehej konferencave apo ftesave akademike.

Ishte momenti që të bisedonim, të diskutonim, të kujtonim e të reflektonim bashkë për një periudhë të gjatë jete e pune prej shkencëtari e njeriu. Fliste sikur gjithë jetën ta kishte pasur të shtruar me pupla dhe nuk ngrinte zërin edhe atëherë kur kujtonte ditët më të vështira të jetës së tij. Fliste për kohët, kolegët dhe pasionet e tij prej shkencëtari, fliste me respekt për mësuesit e tij, për mësuesit e tij të jetës e të veprës.

Kujtuam propozimin e Profesor Jup Kastratit për vazhdimin e *Historisë së albanologjisë*, për presionin tim që pas *Fonetikës* dhe *Morfologjisë historike* të vazhdonte me *Sintaksën historike* dhe u ndalëm gjatë nëse mund të bashkoheshim më shumë të rinj nën drejtimin e tij për të plotësuar *Studimet etimologjike* të Profesor Çabejt.

Qeshte duke fërkuar duart, të lodhura edhe në dukje të parë. Do të më duhet edhe një jetë e tërë për këtë nismë, thoshte.

Nuk mjafton të shkojmë më larg, le të shohim si po punojnë suksesshëm fqinjët që ta arsyetojnë këtë, insistoja unë. Për albanologjinë dhe institucionet e saj është me interes që kjo traditë të vazhdojë e ndërldhur fortë në linjën: Majer-Pedersen-Jokli-Çabej-Ajeti-Demirajt-Luka-Koleci dhe përsëri Demiraj i Ri. Përvoja e fqinjëve tanë na i ka dhënë disa mundësi. Kroatët, bie fjala, jo vetëm nuk kanë hequr dorë nga etimologu i madh Petar Skok, po të gjitha vëllimet e reja i fillojnë me bazë të tri vëllimet etimologjike të tij. Bullgarët ndërkaq nga vitit 1968 vazhdojnë të punojnë në *Fjalorin etimologjik* duke plotësuar Bashkautorët e këtyre vëllimeve me zëvendësimin e atyre që i japin lamtumirën kësaj bote. Grekët, që kanë më shumë mundësi dhe kapacitete shkencore, tashmë në versionin e fundit bënë mjaft revidime në botimin më të ri, duke përfshirë këtu edhe disa etimologjizma të shqipes e të ilirishtes. Serbët sapo kanë filluar me tri vëllimet e para, që nuk turpërohen fare t’i quajnë *Fletore*, jo pse ato vëllime nuk kanë më shumë se 250 faqe, po sepse janë të vetëdijshëm për peshën që kanë veprat në fushë të etimologjisë. Malazezët ende janë në fillimet e tyre me *Fjalorin* standard, si edhe boshnjakët. Sllovenët, ende me dy vëllimet e viteve ’70 të dhe ndjehen komod. Ne shqiptarët, besoj krahas bullgarëve dhe grekëve (nuk e di për rumunët) kemi ecur mjaft përpara ekemi bërë hapa të mirë në këtë drejtim, por mendoj se koha është të kthehemi në bazë: të bashkohemi të *Studimet etimologjike në fushë të shqipes*. Dhe të bashkohemi jo një e dy po edhe rreth dhjetë të tjerë, duke përplotësuar fushat më të rëndësishme të tij...Përsëri buzëqeshje dhe përsëri durim i madh për të dëgjuar deri në fund, pa asnjë ndërhyrje!

Kush i kishte lexuar veprat e tij sintetike, studimet e tij, diskutimet e tij për theksin në gjuhën shqipe, për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe, për zhvillimin historik të diftongjeve të

shqipes, për shndërrimet historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe, për sonantet e gjuhës shqipe, për mbylltoret e gjuhës shqipe, për fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe, për dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe, për bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe, për evolucionin historik të përmrave të shqipes, për nyjat e shqipes, për sistemin rasor të emrave të shqipes, për sistemin foljor të gjuhës shqipe, për bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe etj., nuk e ka vështirë të shoh se si aty bashkohen sinteza e madhe e gjuhësisë shqiptare të dy shekujve të fundit, arritjet më të mira dhe më të thella.

Kështu, biografia e jetës dhe biografia e shkrimit të veprës së tij janë bërë dy pjesë të një tërësie, janë jeta dhe vepra njëkohësisht, biologjia e jetës dhe veprës, siç do të shprehej Jeronim de Rada. Brenda këtyre rrethanave asnjëherë të liberalizuara dhe asnjëherë pa ‘fajin e të qenit ndryshe’ në shoqërinë shqiptare, e kjo do të thotë edhe pa perspektivën e të vlerësuarit ndryshe në jetën shkencore dhe sidomos nga institucionet arsimore dhe shkencore shqiptare, Profesor Kolec Topalli ka bërë kërkimet e tij shkencore në teren dhe në institucionet shkencore, arkivore e arsimore, ka ndërtuar sintezën e madhe të synimeve të tij shkencore, ka provuar kur me zë, kur me heshtje, e kur më kumbueshëm, ligjërimin e tij në konferencat shkencore kombëtare e ndërkombëtare, ka formuluar konceptet e tij shkencore për prirjet teorike të tij dhe për prirjet metodologjike të studimeve albanologjisë, për tërësinë e trashëgimisë gjuhësore shqiptare dhe asaj të vjelë nga kontaktet gjuhësore, për trashëgiminë shkencore të kërkimeve albanologjisë, për konceptet e diskutimeve dhe polemikave të deritashme etj.

Prej studimit të tij të parë, në të cilin merrej me gërshetimin e parimit fonetik dhe morfologjik në disa rregulla të drejtshkrimit të shqipes, të lexuar në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), e deri te sinteza e fundit “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” ka një varg zbrazëtish, të cilat mbulohen me heshtje, me heshtje krijuese dhe kumtuese, me heshtje të ngujuara në fshatrat më të thella të malësisë së Veriut të Kosovës, Jugut të Çamërisë e gjakut të shprishur të arbëreshëve të Italisë. Por, ja kjo është vetëm njëra anë e të vërtetës historike. Ndërkohë që qarqet zyrtare të pushtetit mendonin se studiuesin e ri jo vetëm po e pengonin te rrezikonte frymën komuniste të institucioneve shkencor, profesor Kolec Topalli në vetminë e një murgu, në zonën më arkaike të shqipes së shkruar zbulonte, mbledhte dhe rindëronte rrënojat historike të kështjellës së saj: për prejardhja e popullit shqiptarë dhe gjuhës shqipe (kujtojmë këtu tekstet mbi: gjuhën shqipe dhe fenomenet e dukuritë gjuhësore, fenomenet gjuhësore të karakterit dialektor, fenomene gjuhësore të karakterit libror, gjuhën shqipe dhe ballkanistikën, gjuhën shqipe dhe indoevropianistikën); tekstet për personalitet më të rëndësishme të albanologjisë (të huajt dhe vendorët); studimet për probleme të fonetikës historike dhe të historisë së saj, studimet për probleme të morfologjisë historike, për probleme të sintaksës historike, për çështje të gramatikës së sotme të shqipe (për fonetikën, për morfologjinë dhe për sintaksën) etj; për çështje të kulturës së shqipes së sotme (për standardin, për kulturën e shkrimit dhe për toponiminë) etj.

Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe është një nga sintezat e tij më të mëdha dhe një nga korpuset më të thella sintetike të shqipes, me të cilën nuk identifikohet vetëm autori i saj po edhe albanologjia në kuptimin e saj të gjerë.

Në pamundësi që brenda një kohe të shkurtër të sjell një analizë të gjerë për këtë vepër monumentale të tij, këtu po i theksoj vetëm disa veçori përfaqësuese:

1. Vepra e Profesor Kolec Topallit vjen si një vazhdimësi e traditës së studimeve etimologjike të shqipes, të cilat për fatin e mirë të saj, metodologjiksht dhe konceptualisht përbën në vete edhe arritjet më të mira jo vetëm të zhvillimeve të brendshme të saj, po edhe të shkollës europiane

përgjithësisht. Duke parë arritjet e saj, metodat e zbatuara dhe referencat e leksikut të marrë në shqyrtim, e kjo do të thotë, duke parë arritjet e kësaj veprë në kontekst të fjalorëve dhe veprave studimore të kësaj natyre nga Rasku te Gustav Majeri, nga Pedersen te Norbert Jokli, nga Eqrem Çabej e Idriz Ajeti te David Luka, nga Vladimir Oreli te Bardhyl Demiraj, nuk është vështirë të shihet vazhdimësia e një tradite mbi dyshekullore e qasjes metodologjike në studimet etimologjike, sidomos të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX.

2. Fjalori etimologjik i Kolec Topallit, në kontekstin metodologjik nuk mund të thuhet se i tejkalon më pak a më shumë veprat e autorëve të theksuar më lart, sepse në kërkimet e tij etimologjike ai nuk ka zbatuar shkolla apo metoda bashkëkohëre të gjysmës së dytë të shekullit XX, për njohjen dhe zbatimin e të cilave nuk janë interesuar as bashkëkohësit e tij, e megjithatë atij nuk i ka munguar pasioni që në veprën e tij të ndërtojë një stil të vetin për përzgjedhjen apo rimarrjen dhe diskutimin e indikacione etimologjike, brenda një gjedhe të strukturuar të tij. Ndryshe nga bashkëkohësit e tij kroatë, bie fjala, të cilët rimarrjen, përkatësisht zgjerimin dhe thellimin e etimologjive të veprës së Petar Skokut e kanë bërë duke e trajtuar atë edhe mbi metoda të reja të gjuhësisë bashkëkohore (semantizmin, semasiologjinë e distribucionalizmin), Prof. Topalli projektin e tij e ka rindërtuar mbi po ato metoda dhe koncepte mbi të cilat kanë punuar etërit tanë të gjuhësisë historike. Dhe kishte të drejtë. Vepra e Profesor Topallit është projekti i parë gjithëpërfshirës i etimologjisë së shqipes. Ndryshe nga projektet e paraardhësve të tij, të cilët *Fjalorët* dhe vëllimet etimologjike të tyre i projektonin mbi pasurinë leksikore të shqipes me theks të veçantë arbërishten e Italisë (Majer); arbërishten e Greqisë (Pedersen); leksikun bujqësor e blegtoral (Jokli); totalitetin etnik e historik të gjuhës së shkruar dhe të folur (Çabej); shtrirjen dialektore të leksikut të përzgjedhur (Luka); leksikun e raporteve shqiptaro-sllave (Ajeti, Hoxha e Omari) etj., qasja e tij, në kontekst të kërkimit duket i arsyeshëm sot dhe obligues ndaj brezave të tjerë, të cilët do të vazhdojnë të merren me etimologjinë e shqipes. Në veprën e tij, sikur do të shprehej Selman Riza, ai nuk ka lënë gjë mangut në hulumtimin filologjik të njësisë leksikore, duke i parë ndryshimet, format dhe kuptimet e fjalëve brenda teksteve të mesjetës shqiptare; praninë, përkatësisht shtrirjen dhe trajtat e saj dialektore, sado, sikur shprehet në parathënie të veprës në shkallë përzgjedhjeje, përmes të cilave ai ka bërë rindërtime historike të moshës së tyre më të hershme; ka përdorur metodën krahasuese sado modeste qoftë ajo, dhe ka bërë krahasime sistematike të leksikut të shqipes me leksikun e gjuhëve të ngjashme, duke i parë rrënjët e etimologjisë. Brenda njësive etimologjike të Fjalorit nuk mungojnë as hipotezat, me të cilat një numër njësish gjuhësore, rishikohen edhe njëherë, mbi bazë të ndryshimeve semantike të saj, natyrisht mbështetur në hipoteza të reja, me të cilat kundërshtohen njohuritë përgjithshme të ndërrimeve semantike, kur si koncepte politike, sikur ndodhë me disa fjalorë të gjuhëve fqinje, kur si koncepte folklorike të diskutimeve brenda gjuhës shqipe.

3. Fjalori etimologjik i Kolec Topallit është sinteza e madhe etimologjike edhe në kontekst të përzgjedhjes së tij leksikore edhe në kontekst të përzgjedhjes së referencave përfaqësuese. Njësitë e trajtuara dhe referencat e rimarra leksikore dhe onomastike jo vetëm sjellin mbështetje të mjaftueshme për përcaktimin fillestar të etimologjisë së saj, por lënë hapësirë që ato të rimerren dhe të trajtohen edhe brenda metodave të tjera semantike e semasiologjike.

4. Fjalori etimologjik i Kolec Topalit ridimensionon një korpus të pasur njësish leksikore të provinencës dialektore, periudhave historike, të teksteve dokumentare, të gjuhëve fqinje dhe gjuhëve të familjes indo-europiane, me të cilën ka bashkëjetuar, është ofruar dhe ka marrë e dhënë gjuha shqipe. Nëse i përmbahemi konceptit të Baldingerit për biografinë e fjalëve, si biografi të jetës së popujve, përkatësisht të mënyrës së jetës së tyre, nuk mund të mos theksojmë këtu, se me këtë veprë

Profesor Topalli ka sjellë një pasuri të jashtëzakonshme, që dëshmonë botën materiale e shpirtërore, historike e gjeografike, sedentare e konceptuale të popullit shqiptar.

Mund të themi madje se jo vetëm në këtë vëllim po në gjithë veprën e tij, bashkohen në mënyrë të veçantë sintezat e mëdhaetimologjike të Profesor Çabejt dhe sintezat e mëdha gramatikore të Profesor Demirajt. Në të vërtetë, tek vepra e tij bashkohen: sinteza e hapur e dijes çabejane dhe modeli i diskutimit sistematik të Profesor Demirajt.

Le të përfundojmë

E kam përcjellë prej më shumë se dy dekadash punën shkencore të Profesorit e mikut tim Kolec Topallit dhe po kaq kohë kemi komunikuar deri më datën 1 prill 2018 (mesazhi i tij i fundit) kur diskutuam për përkthimet e Mithat Aranatit, me theks të veçantë *Fjalorin etimologjik* të Walde-Pokornyt.

Sapo kishte parë një platformë të veprës së tij, projektuar që më parë prej meje, përmes një miku, më kishte dërguar versionin italisht të veprës së tij të parë “Theksi në gjuhën shqipe” (“Ricerche sulla storia dell’accento in albanese”, Cosenza, 2007).

Më dërgoi edhe versionin e fundit të bibliografisë së tij dhe shpreha gatishmërinë që gjatë kësaj “periudhe pushimi”, ta ndihmoja përgatitjen e vëllimeve me studime (e pse jo edhe me intervista e tekste publicistike), që do të ishin rezultat i studimeve, kumtesave dhe diskutimeve të shpërndara ndër konferenca shkencore, gazeta e vlerësime rasti. Nuk e dija ndërkaq se Profesor Kolec Topalli kishte nevojë më shumë se për një pushim viti, ai kishte nevojë për një pushim motesh.

Dhe pse të mos e bënte! Kishte përfunduar *Fjalorin etimologjik të shqipes* dhe gjendej në Majën e Piramidës së Albanologjisë, prej së cilës vetëm mund të fluturonte si një Shterg i fundit i albanologjisë, asaj dijeje kulminante, të cilën na e ka lënë brezi i madh i gjuhëtarëve në kapërcyell të shekullit XXI.

Profesor Kolec Topalli ishte aq tokësor me jetën dhe po aq qiellor me veprën!

Prandaj, lavdia e veprës së tij është bashkuar kaq natyrshëm me lavdinë e arritjeve më të mira në fushë të Albanologjisë!